

LIGJ
Nr.10 049, datë 24.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7811, DATË 12.4.1994
“PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.782, DATË 22.2.1994
“PËR SISTEMIN FISKAL NË SEKTORIN E HIDROKARBUREVE
(KËRKIM-PRODHIM)””

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7811, datë 12.4.1994 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim)””, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 1, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kontraktuesi detyrohet të paguajë, në çdo vit fiskal, tatimin mbi fitimin e realizuar në atë vit fiskal, si dhe taksën e rentës minerare për hidrokarburet që nxjerr nga nëntoka.

Tatimi mbi fitimin tërhiqet në para, siç parashikohet në çdo marrëveshje hidrokarburesh.

Taksa për rentën minerare paguhet në sasinë dhe sipas procedurave, që përcaktohen në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6006, datë 13.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi